



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 158, Datë 05.05.2023

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “EU GREEN ENERGY” SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA PARKU EOLIK I ERËS “DROPULLI WIND”, ME KAPACITET TË INSTALUAR 20 MW, NË NJËSINË ADMINISTRATIVE JORGUCAT, BASHKIA DROPULL, QARKU GJIROKASTËR

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “a”, nenit 5, pika 1, gërma “a” dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 dhe nenit 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 05.05.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1069/3 prot., datë 03.05.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “EU GREEN ENERGY” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga parku eolik i erës “Dropulli Wind”, me kapacitet të instaluar 20 MW, në Njësinë Administrative Jorgucat, Bashkia Dropull, Qarku Gjirokastër”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “EU GREEN ENERGY” sh.p.k. me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1069, datë 15.03.2023 ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga parqet eolike të erës “Dropulli Wind”, për fazën e parë dhe të dytë të zhvillimit “Dropulli Wind-1” dhe “Dropulli Wind-2”.
- Miratimi paraprak, nr. 469/5, datë 07.12.2021 i lëshuar nga Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës (MIE) “Për ndërtimin e impiantit gjenerues të energjisë elektrike eolike, me kapacitet të instaluar 20 MW, i cili nuk përfiton nga masat mbështetëse dhe veprave ndihmëse në Njësinë Administrative Jorgucat, Bashkia Dropull, Qarku Gjirokastër” i është dhënë bashkimit të përkohshëm të shoqërive “EU GREEN ENERGY” sh.p.k., “WINPHARMA” sh.p.k. dhe “A.91” sh.p.k., për projektin e ndërtimit të centralit eolik me kapacitet të instaluar 20 MW. Në këto rrethana, ERE do të vlerësojë dokumentacionin

e depozituar në kuptim të fuqisë 20 MW, pasi edhe formati i aplikimit me të dhënat teknike sipas shtojcës 2 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, në gjermën “a” kur trajtohet kapaciteti i instaluar, shoqëria e ka plotësuar këtë zë me fuqinë 20 MW.

- Duke qenë se në ERE nuk rezultojnë që të jetë depozituar ndonjë akt ku të tria shoqëritë apo MIE të kenë dhënë miratimin e tyre që licenca t’i jepet shoqërisë “EU GREEN ENERGY” sh.p.k., e cila është shoqëria që ka paraqitur aplikimin në ERE dhe po ashtu shoqëria së cilës i është dhënë VNM Paraprake dhe Miratimi në parim i pikës së lidhjes me rrjetin e transmetimit do të sqarohet me aplikuesin apo edhe me MIE-n, në lidhje me përcaktimin e shoqërisë që do të marrë licencën që do të operojë centralin eolik “Dropulli Wind”.
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit, sipas përcaktimeve të Aneksit A të rregullores.
- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të depozituar nga shoqëria “EU GREEN ENERGY” sh.p.k. rezultojnë se ai është plotësuar në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, gjermat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gjermat “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, gjermat “a” dhe “c” dhe për pikën 2.1, gjermat “a”, “d” dhe “e”.
- Nga ky aplikim rezultojnë gjithashtu se nevojitet të plotësohet dokumentacioni si vijon:

NENI 9

Pika 2, Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës

2.1 Për t’u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike, aplikuesi duhet të depozitojë gjithashtu:

- **gjërma “b”:** Shoqëria duhet të depozitojë në ERE **autorizimin përkatës për miratimin e ndërtimit të këtij projekti dhe/ose kontratën e nënshkruar me MIE.**
 - **gjërma “c”:** Shoqëria në vijim të miratimit paraprak të pikës së lidhjes me rrjetin e transmetimit nga OST sh.a., duhet të depozitojë miratimin përfundimtar për pikën e lidhjes me rrjetin.
- Për sa parashikuar në VNM-në Paraprake në lidhje me zbatimin në terren, shoqëria duhet të depozitojë në ERE informacion mbi fillimin apo fazën në të cilën ndodhen punimet për ndërtimin e veprës.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “EU GREEN ENERGY” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga parku eolik i erës “Dropulli Wind” me

kapacite të instaluar 20 MW, në Njësinë Administrative Jorgucat, Bashkia Dropull, Qarku Gjirokastrë.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “EU GREEN ENERGY” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI